



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:037545

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05731704

K.DH.SH.II.nr.1592/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Saranda Bogaj Sheremeti kryetare e kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Faton Bajrami, anëtar, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit N.T “Bryma Shped” me seli në Katunishtë-Podujevë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson S.Z., kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, KF.nr.228/22 i datës 28.09.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 24.05.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit N.T “Bryma Shped” me seli në Katunishtë-Podujevë e datës 09.11.2023, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, KF.nr.228/22 i datës 28.09.2023, **Vërtetohet.**

A r s y e t i m i

Dhoma e Shkallës së Parë, me aktgjykimin e ankimuar, nën pikën I. të dispozitivit ka vendosur, Aprovohet kërkesëpadia e paditësit N.T “Bryma Shped” me seli në Katunishtë-Podujevë, si e

bazuar. Nën pikën II. Anullohet vendimi nr.332/2020 i datës 18.11.2020 i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosi. Nën pikën III, Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimit, në afat ligjor ankesë ka ushtruar paditësi, me të cilën e kundërshton ligjshmërinë e aktgjykimit për shkak të; konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljeve procedurale dhe aplikimit të gabuar të ligjit material, me propozim që të aprovet në tërësi si e bazuar ankesa e paditësit “Bryma Shped” me NUI 810780743, me adresë në fshatin Katunishtë-Komuna e Podujevës, të anulohet aktgjykimi KF.nr.228/22 i datës 28.09.2023 i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal dhe vendimi nr.332/2020 i datës 18.11.2020 i Departamentit të Ankesave-Administratës Tatimore të Kosovës. Obligohet e paditura që gjendjen në sistem për periudhën e kontrollit ta rregulloj sipas deklaratave të tatimpaguesit ose rastin ta kthej në Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, duke detyruar që kjo e fundit të nxjerr vendim merititor.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e Aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.h, të Ligjit, nr.04/L-102, për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurën nr.03/L-222, dhe nenit 194 i LPK-së, (ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së), në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është **e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se, e paditura me vendimin nr.332/2020 i datës 18.11.2020, në pikën I. të dispozitivit ka refuzuar si të pa bazuar ankesën nr.332/2020 e datës 07.10.2020 e subjektit “Bryma Shped” numër fiskal (NUI) 810780743, me pronar z.Safet Bryma, me seli të biznesit në adresën: Velikorek-Podujevë në mbështetje të nenit 132/2 të Ligjit nr. 05/L-031 “Për Procedurat Administrative” në lidhje me nenin 89, paragrafin 2 të Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Njoftim Rivlerësimi i Tatimit shtesë i caktuar me kontroll vërtetohen si të bazuara. Nën pikën II. Procedura e ankesës nuk ndërprente obligimin e tatimpaguesit për pagesë të detyrimeve tatimore (tatim, ndëshkime dhe interes) në përputhje

me nenin 9, paragrafi 1 të Ligjit nr. 04/L-102 për Ndryshim Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

I pakënaqur me vendimin e ATK-së, subjekti ushtron padi në Gjykatën, në procedurë të konfliktit administrativ, Dhoma e Shkallës së Parë- Departamenti Fiskal pas administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor të datës 28.09.2023 në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse e në mungesë të palës së paditur, pas vërtetimit të gjendjes faktike gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar me të cilin e aprovon kërkesëpadinë e paditësit, e anulon vendimin nr.332/2020 i datës 18.11.2020 të Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, sipas konkludimeve ndër të tjera në arsyetim se; gjykata bazuar në nenin 43 par.3 të LKA-së dhe përkundër faktit se në këtë kontest tregtar administrativ është bërë nxjerrja e provës përmes ekspertizës financiare dhe se nëse në bazë të dokumentacionit zyrtar-ekspertizës financiare të datës 24.07.2023 të punuar nga eksperti financiar Shaip Bytyqi në raport edhe me provat e tjera në shkresat e lëndës nuk janë bërë tërësisht të qarta pikat kontestuese lidhur me deponimet e bëra nga paditësi në periudhën 2014 dhe 2016, atëherë gjykata vlerëson se në këtë lëndë të kontestit tregtar administrativ nuk ka mundur të vërtetohet saktë në tërësi gjendja faktike dhe as me anë të organit tjetër respektivisht me ekspertizën financiare të datës 24.07.2023. gjykata konstaton se vendimi i kontestuar nuk përmban arsyet mbi faktet vendimtare të vlefshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes në shqyrtim. E paditura në arsyetim të vendimit kontestues ka përshtuar vetëm bazën ligjore dhe atë nenin 19 nga Ligji 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, si dhe nenin 30 të UA 15/2010. E paditura një konstatim të tillë do të duhej ta bazonte në prova dhe dëshmi konkrete dhe jo vetëm ti mjaftonte konstatimi abstrakt dhe se arsyetimi i tillë i pa qartë dhe kontradiktor është i barsvlefshëm me mungesë të arsyetimit e që paraqet shkelje në dëm të këtu paditësit e pa evidentimin e të cilës nuk mund të procedohet tutje. E paditura as në Raport të Kontrollit por as në vendimin kontestues nuk ka konstatuar statusin e mjeteve të deponuara gjatë periudhës së kontrollit 2014 dhe 2016. Nuk mjafton që e paditura në vendimin kontestues vetëm të theksoj se është obligim i këtu paditësit të dëshmoj prejardhjen e mjeteve të deponuara në llogari bankare, ngase para kësaj është obligim i vet të paditurës që në rastet kur vlerëson qarkullim nga e cila mund të dal obligim tatimor për tatimpaguesin të konstatoj statusin e saktë të mjeteve të deponuara në llogari bankare, pra të njëjtat nga e kanë prejardhjen gjithmonë duke e ndërlidhë dhe vlerësuar me çdo provë veç e veç, të analizoj ditarin e arkës, hyrje daljet e keshin në arkë, saldot fillestare të vitit 2014, dhe ato të bartura në vitet pasuese deri në vitin 2019, të metat e

lartcekura janë të tilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, prandaj Gjykata në rivendosje e obligon të paditurën që të deklarohet lidhur me çështjet e theksuara si më lart dhe të marr për bazë edhe gjetjet nga ekspertiza financiare e datës 24.07.2023, të ekspertit financiar Shaip Bytyqi në këtë lëndë të kontestit tregtar administrativ. gjykata vendosa për çështjen e kontestit tregtar administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative në bazë të nenit 43 paragrafi 1 të LKA-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, i pranon në tërësi si të drejta dhe ligjore konkludimet juridike të Dhomës së Shkallës së Parë, sa i përket gjendjes faktike të çështjes, e gjithashtu aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ, të cilat shkelje Dhoma e Shkallës së Dytë i ekzaminon sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 49 të LKA dhe 194 të LPK. Kolegji vlerëson se Dhoma e Shkallës së Parë, drejtë ka vendosur gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, në drejtim të thënieve në padi, përgjigjes në padi, si dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor dhe ka vlerësuar drejtë, se kërkesë padia e paditësit është e bazuar, duke e anuluar vendimin nr.332/2020 i datës 18.11.2020 të Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje.

Pretendimet ankimore të paditësit nga bazat ankimore të theksuara si më lartë si dhe pretendimet e tjera si në arsyetim të ankesës, kolegji i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i vlerëson se nuk janë të qëndrueshme, sepse nuk janë të bazuara në prova dhe fakte të dëshmuara, andaj kolegji gjen se aktgjykimi i ankimuar, nuk është i përfshirë me shkelje procedurale dhe ligjore siç pretendohet, sepse e njëjta ka shqyrtuar padinë, përgjigjen në padi pastaj ka caktuar seancë të shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme e që kuptohet se gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së. Dhoma e shkallës së parë, në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative në vështrim të nenit 43 paragrafi 2, të LKA-së. në bazë të këtij parimi Gjykata e ka të pamundur të vendos në mënyrë meritore në këtë konflikt administrativ për arsye se ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, andaj e aprovon padinë e paditësit e anulon vendimin e kontestuar dhe lëndën e kthen në rishqyrtim dhe rivendosje. Gjykata bazuar në autorizimet nga neni 43 paragrafi 2 dhe 65 të LKA-së e detyron të paditurën që në ri procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të aktgjykimit.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se Dhoma e Shkallës së Parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga Dhoma e Shkallës së Parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i Dhomës së Shkallës së Parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadiës së paditësit duke e kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

K.DH.SH.II.nr.1592/23, me datë 24.05.2024

**Kryetare e kolegjit,
Saranda Bogaj Sheremeti**